

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

Kryesia e Kuvendit  
P-041  
Prishtinë, më 24 nëntor 2008, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 24  
NËNTOR 2008

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku dhe Xhezair Murati, ndërsa munguan, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan Ibrahim Makolli, Lutfi Haziri dhe Bojan Stojanoviq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Avni Zuka, dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Në fillim të mbledhjes, për fjalë u lajmërua anëtari i Kryesisë, **Ibrahim Gashi**, i cili në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së propozoi që në seancën e radhës, si çështje urgjente, të diskutohet lidhur me propozimin e 6-të pikave të sekretarit të OKB-së për Kosovën dhe për situatën e krijuar të raportojnë Presidenti dhe Kryeministri i vendit

Kryetari th se kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim, në përputhje me rregullat procedurale.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** kërkoi që në seancën plenare të 27 nëntorit 2008 të zgjatet koha e debatit për Interpelancë.

Naim Maloku dhe Ardian Gjini mbështetën kërkesën e Lulzim Zenelit.

Pas diskutimeve lidhur me propozimin e cekur më lart, Kryesia konkludoi që seancës plenare mund t'i propozohet zgjatja e kohës së debatit lidhur me Interpelancën.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 nëntor 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 nëntor 2008, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Njoftimi për heqjen nga rendi i ditës të seancës së ardhshme plenare të rishqyrtimit të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit**

Kryesia miratoi heqjen e rishqyrtimit të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit nga rendi i ditës së seancës së ardhshme plenare, kurse sqarimet do të jepen në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë.

#### **3. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për t'i radhitur në rend dite të seancës së ardhshme për shqyrtim të parë katër (4) projektligje nga pakoja e Buxhetit**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e Qeverisë së Kosovës, vendosi që katër (4) projektligje nga pakoja e Buxhetit të procedohen për shqyrtim pasi t'i plotësojnë kushtet procedurale në seancë tjetër të radhës, si vijon:

1. Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar,
2. Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave,
3. Projektligji për tatimin në të ardhurat individuale, dhe
4. Projektligji për normën e akcizës.

#### **4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit për procedimin e Projektregullores së Kuvendit**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, vendosi që Projektregullorja e Kuvendit t'u dërgohet deputetëve të Kuvendit dhe të procedohet për shqyrtim në pajtim me rregullat procedurale

#### **5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Raportin nëntëmujor të Buxhetit për vitin 2008**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, vendosi që Raporti nëntëmujor i Buxhetit për vitin 2008 të radhitet për shqyrtim në seancën tjetër të radhës.

#### **6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për miratim në Kuvend të marrëveshjes për emërimin e Komisionit për Emërime të Larta Publike**

Kryesia nuk e mbështeti Propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e Komisionit për Emërime të Larta Publike për ta proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, me arsyetimin se kjo çështje duhet të rregullohet me ligj.

#### **7. Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit**

##### **7.1 Shqyrtimi i reagimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me koordinimin e vizitave jashtë vendit**

Kryesia, pasi shqyrtoi reagimin e Komisionit për Integritet Evropian, konkludoi se duhet të nxirret një Rregullore e veçantë për të rregulluar çështjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

##### **7.2 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, vendosi që anëtarëve të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media t'ua lejojë udhëtimin zyrtar në Kroaci, prej 3 deri më 6 dhjetor 2008.

##### **7.3 Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të Komisionit për Shërbime Publike, Esat Brajshori, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi.**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, vendosi që kryetarit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media t'ia lejojë udhëtimin zyrtar në Turqi, prej 30 nëntor deri më 2 dhjetor 2008.

## **8. Të ndryshme**

**Naim Maloku** ngriti dy çështje:

- a) Që Kryesia e Kuvendit t'i rekomandojë Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që të kërkojë Raport me shkrim nga ART-ja lidhur me funksionimin operatorëve ilegalë të telefonisë mobile në Kosovë, dhe
- b) Që Kryesia të diskutojë lidhur me çështjen e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi.

Kryetari tha se kërkesat duhet të parashtrahet me shkrim, në përputhje me rregullat procedurale.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**